



Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve

**Analizë mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet
financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare**

Korrik 2018

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
I. Hyrje.....	3
II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve	4
A. Tregu i sigurimeve	4
1. Informacion mbi primet bruto	4
2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit	7
B. Tregu i Kapitaleve	11
1. Tregu me pakicë	Error! Bookmark not defined.
2. Bursa Shqiptare e Titujve	Error! Bookmark not defined.
3. Obligacionet me ofertë private në Euro.....	Error! Bookmark not defined.
C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve.....	Error! Bookmark not defined.
III. Përfundime	15

I. Hyrje

Ministria e Financave dhe Ekonomise, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” në muajin prill të vitit 2017, ku angazhohen të ndërmarrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin, monitorojnë apo operojnë në aktivitetin e tyre.

Duke qene se në vendin tonë është krijuar një traditë e përdorimit të gjerë të monedhave të huaja (valutat), kryesisht te Euros dhe dollarit amerikan, masat që duhet të ndërmerren për minimizimin e përdorimit të monedhave të huaja duhet të jenë të kujdesshme dhe të argumentuara, për të qenë efektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (me tej, Autoriteti) lidhur me përdorimin e monedhave të huaja në tregjet që mbikëqyr, është duke punuar me operatorët dhe investitorët për masat që duhet të ndërmerren për të minimizuar përdorimin e monedhave të huaja në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Lidhur me veprimtarinë në valutë, në këtë raport janë përfshirë:

Informacion për tregun e sigurimeve sipas produkteve dhe investimeve nga shoqëritë, informacion për fondet e investimeve dhe të pensioneve vullnetare private. Disa nga produktet financiare të këtyre institucioneve, operojnë në valutë për arsye objektive.

Të tillë janë, për shembull disa produkte të sigurimit të detyrueshëm motorik, si polica kufitare dhe kartoni jeshil. Produkti i Kartonit Jeshil është produkt ndërkombëtar sigurimi, i cili lëshohet në monedhën Euro, pasi edhe detyrimet që i linden shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pagesë dëmshpërblimi nga ky sigurim janë në Euro. Polica kufitare lëshohet në pikat e kalimit kufitar gjatë hyrjes së automjeteve me targa të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagesa e primit të policës në monedhën vendase do të vështirësonte procesin e pajisjes së konsumatorit me këtë policë sigurimi. Po kështu, disa nga produktet kryesore të aktivitetit të sigurimit, si sigurimi i pronës me përfitues bankat tregtare ose sigurimi i Jetës së debitorit, janë të lidhura ngushtësisht me monedhën e kredisë. Monedha në të cilën disbursohet kredia dikton dhe monedhën e lëshimit të policës, për shkak të nevojës për të rikuperuar në të njëjtën monedhë vlerën e detyrimit, në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Tek fondet e investimit, në disa prej tyre, natyra e profilit të veprimtarisë kërkon investimin e tyre në aksione apo tituj të tregjeve ndërkombëtare, pra realizohet në valutë. Sidoqoftë, Autoriteti vepron në mbështetje të kuadrit rregullativ për të kufizuar rrezikun e kursit të këmbimit për këto institucione dhe për investitorët në këto tregje. Në këtë drejtim, Autoriteti do të vleresojë nevojën për masa të reja.

II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve

A. Tregu i sigurimeve

1. Informacion mbi primet bruto

Referuar të dhënave të 31.03.2018, primet e shkruara bruto¹ rezultojnë për të gjithë aktivitetin e tregut të sigurimeve Jo-jetë dhe Jetë në rreth 3.6 miliardë lekë. Rreth 32% e tyre është realizuar në monedhën Euro.

Sipas llojit të sigurimeve, aktiviteti i sigurimit të Jetës rezulton me nivel më të lartë të euroizimit me rreth 37% të primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit. Aktiviteti i sigurimit të Jo-Jetës, i cili dikton dhe ecurinë e tregut në total, paraqet rreth 35% të primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit.

Në mënyrë më të detajuar vihet re se përveç produkteve të kartonit jeshil dhe sigurimit kufitar ka edhe disa nga produktet vullnetare që rezultojnë me të ardhura 100% të realizuara në Euro, siç janë produktet e sigurimit të detyrueshëm të Kartonit Jeshil dhe Kufitare, dhe ato vullnetare të sigurimit të shëndetit dhe jetës në udhëtim, sigurimit të jetës së studentëve, si dhe sigurimit të jetës së depozitorit. Gjithashtu, produktet që shfaqin një vlerë të primeve të shkruara në përqindje të lartë në euro janë edhe produktet e Kaskos, ato inxhinierike si sigurimi i të gjitha risqeve në ndërtim (CAR),² dhe sigurimi i të gjitha risqeve në montim (EAR)³ në aktivitetin e Jo-Jetës dhe Flexi plan⁴ për atë të Jetës. Ndërkohë, produktet si sigurimi i mallit në transport apo sigurimet inxhinierike paraqesin një nivel të lartë euroizimi për shkak të interesit të siguruar nga këto kontrata, interes i cili vlerësohet kryesisht në Euro në rastet e import-eksporteve, dhe sigurimeve inxhinierike që përfshijnë vepra madhore të infrastrukturës përfshirë ato me shoqëri ndërkombëtare.

Paraqitja e mëposhtme tregon peshën e primeve të shkruara bruto në Euro kundrejt totalit të këtyre primeve për aktivitetin e sigurimit të Jo-jetës, për periudhën 31.03.2017 dhe 31.03.2018.

Siç vërehet edhe nga grafiku 1, si më poshtë, në 31.03.2018 pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt atyre në Lekë për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë karakterizohet nga një rritje e lehtë, me 1%, në krahasim me 31.03.2017.


¹ Primet e shkruara bruto janë të ardhura për shoqëritë e sigurimit. Si të tilla, këto dy terma përdoren në këtë material si zëvendësues të njeri-tjetrit.

² Policë sigurimi që ofron mbulimin në sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve.

³ Policë sigurimi që merr përsipër të paguajë për dëmtimet e punimeve në të gjitha fazat e montimit të makinerive dhe pajisjeve në objektet industriale.


⁴ Me anë të produktit Flexi plan, përfitimet janë në rast të humbjes së jetës si pasojë e aksidentit, humbjes së jetës nga faktorë natyrore; paaftësisë së përhershme të plotë; paaftësisë së përhershme të pjesshme, etj.

Grafik 1: Peshat e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë kundrejt totalit për periudhën 3-mujore




Referuar grafikut 2, në fund të vitit 2017 peshat e primeve të shkruara në Euro kundrejt atyre në Lekë për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë karakterizohet nga një rënie tepër të lehtë me 1% nga fundi i vitit 2016.

Grafik 2: Peshat e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë kundrejt totalit për periudhën e fundvitit




Siç vërehet edhe nga grafiku 3, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt atyre në Lekë për aktivitetin e Jetës shfaq një rritje të lehtë me 2%, nga 46% në 31.03.2017, në 48% në 31.03.2018.

Grafik 3: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit të Jetës kundrejt totalit për periudhën 3-mujore



Referuar grafikut 4, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt atyre në Lekë për aktivitetin e Jetës paraqet një ulje të ndjeshme, nga 50% në 31.12.2016, në 39% në 31.12.2017.

Grafik 4: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit të Jetës kundrejt totalit për periudhën e fundvitit




2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit

Depozitat e shoqërive të sigurimit në 31.03.2018, të investuara në monedhat Lek dhe valutë të huaj, rezultojnë në vlerë totale rreth 8.7 miliardë Lekë.


Nga këto depozita në monedhën vendase LEK janë investuar rreth 5.2 miliardë Lekë, ose rreth 60.1% të totalit të depozitave, ndërsa ato në valutë rezultojnë të jenë rreth 3.5 miliardë Lekë, ose rreth 39.9 % të vlerës totale të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat zënë rreth 74.5 % të depozitave totale në valutë dhe 29.7 % të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2017, depozitat në valutë shënojnë një rënie në vlerë dhe në peshë ndaj totalit të depozitave të shoqërive të sigurimit.

Grafik 5: Vlera e depozitave në Lek dhe valutë për tregun e sigurimeve në total



Grafik 6: Pesha e depozitave në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




a) Tregu i sigurimeve jo-jetë


Përsa i përket tregut të sigurimit jo-jetë, në 31.03.2018, rreth 4.8 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose rreth 61.3% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 3 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 38.7% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat kapin vlerën rreth 16.9 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 2.2 miliardë Lekë dhe zënë rreth 73.1 % të depozitave totale në valutë dhe 28.3% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2017, depozitat në valutë kanë shënuar rënie ndaj totalit të depozitave, dhe pesha e Euro-s në depozitat në valutë është ulur lehtë.

Grafik 7: Vlera e depozitave në Lek dhe valutë për tregun e sigurimeve jo-jetë



Grafik 8: Pesha e depozitave në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



b) Tregu i sigurimeve të jetës


Përsa i përket tregut të sigurimit të jetës, rreth 423 milionë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose rreth 49.5% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 431 milionë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 50.5% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat arrijnë vlerën rreth 2.8 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 363 milionë Lekë dhe zënë rreth 84.2% të depozitave totale në valutë dhe 42.5% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Edhe në këtë treg, depozitat në valutë në raport me depozitat totale, kanë shënuar rënie në krahasim me fundin e vitit 2017. Përqëndrimi i përdorimit të euros tek depozitat në valutë në këtë treg, është në nivele më të larta se tregjet e tjera.


Në grafiket 5, 7 dhe 9, paraqiten depozitat në tregun e sigurimeve, në nivel tregu dhe të ndara sipas tregjeve jo-jetë dhe jetë për periudhat 31.12.2017 dhe 31.03.2018.

Në grafikun 6,8 dhe 10, paraqiten peshat e depozitave në valutë në tregun e sigurimeve, në nivel tregu dhe të ndara sipas tregjeve jo-jetë dhe jetë për periudhat 31.12.2017 dhe 31.03.2018.

Grafik 9: Vlera e depozitave në Lek dhe valutë për tregun e sigurimeve të jetës



Grafik 10: Pesha e depozitave në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




B. Tregu i Kapitaleve

Tregu Shqiptar i Kapitaleve, i mbizotëruar nga titujt e borxhit të qeverisë që janë kryesisht në lek, karakterizohet nga një shkallë tepër e ulët e euroizimit. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë treg përdorin kryesisht monedhën vendase. Megjithatë ka edhe emëtues private të titujve që kanë kryer emetime në valutë. Autoriteti do të monitorojë këtë treg, për të vlerësuar ecurinë e treguesve dhe nevojën për masa specifike.

1. Tregu me pakicë

Në përlllogaritjen e tregut me pakicë është përfshirë tregtimi i letrave me vlerë të borxhit (titujve) të qeverisë në monedhën Euro, si dhe blerjet në tregun primar. Ashtu si shihet dhe në grafikun e mëposhtëm, për 3/mujorin e parë të vitit 2018, vlera e transaksioneve në euro është tepër e ulët. Kjo për faktin se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve të Qeverisë Shqiptare në euro. Vlera prej 8.3 milion lekë, i takon transaksioneve në tregun sekondar të obligacioneve 2-vjecare të emetuara në vitet e mëparshme.

Grafik 9: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritare



2. Bursa Shqiptare e Titujve

Bursa Shqiptare e Titujve, e cila filloi aktivitetin në 22 shkurt 2018, ka realizuar transaksione vetëm në titujt e Qeverisë.


Në fund të 3/mujorit të parë të vitit 2018, totali i transaksioneve të realizuara në Bursën Shqiptare të Titujve arriti në 562,015,461 lekë.

3. Obligacionet me ofertë private në Euro

Tregu i kapitaleve iu ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve të financimit për biznesin e tyre. Duke filluar nga dhjetori 2011, emëtimi i obligacioneve nëpërmjet ofertave private ka qënë një burim financimi për banka dhe institucione financiare. Obligacionet janë emëtuar në monedhën vendase dhe në valutë të huaj (EUR dhe USD). Përkatësisht totali i shumës së obligacioneve të emëtuara dhe të pashlyera nëpërmjet ofertave private me 31.03.2018 është: 6.82 miliardë lekë, nga të cilat 41% janë në euro (ekuivalenti në lekë 2.8 miliardë) dhe 7.2 % në USD (ekuivalenti në lekë 494 milionë)

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 nuk vihet re ndonjë ndryshim në strukturën lekë/valutë e huaj në lidhje me obligacionet e emëtuara dhe të pashlyera me ofertë private.

Grafik 10: Obligacionet me ofertë private të emëtuara dhe të pashlyera



C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve

Në 31.3.2018, në tregun e fondeve të investimit operojnë katër fonde, nga të cilët dy fonde investimi kryejnë veprimtarinë në monedhën vëndase lekë, një fond në monedhën Euro. Ndërsa fondi i licensuar në Janar 2018 shitjen dhe blerjen e kuotave e bën në monedhën në lekë, ndërsa investimet i bën në monedha të ndryshme. Ky fond në portofolin e vet zotëron letra me vlerë të denominuara në valuta të ndryshme duke qenë i ekspozuar kështu nga efektet e ndryshimeve të kurseve të këmbimit në çdo ditë vlerësimi të aseteve.

Fondi Raiffeisen Invest Euro, kryen të gjithë aktivitetin e tij në monedhën Euro duke nisur që nga mbledhja e kontributeve të anëtarëve, investimet e aseteve të fondit, tarifa e administrimit si dhe shlyerjet ndaj investitorëve.


Asetet e fondit në Euro janë 104 mln Euro dhe zënë rreth 19.65% të totalit të aseteve të tregut.

Edhe detyrimet e këtij fondi, të cilat përfaqësojnë detyrimin ndaj shoqërisë administruese për tarifën e administrimit dhe detyrime për pagesat ndaj kuota mbajtësit, mbahen përsëri në monedhën Euro dhe zënë rreth 10.06% të detyrimeve të tregut. Dy fondet e tjera të investimit të

cilat operojnë në monedhën lekë nuk kanë investime në monedhën Euro dhe të gjithë asetet dhe detyrimet mbahen në monedhën vendase lekë. Ndërkohë që fondi i investimit WVP Top Invest ka investuar rreth 53.5% të aseteve neto të tij në monedhën Euro ose në vlerë 309 mijë Euro ndërkohë që investimet e fondit në monedhë të huaj përbëjnë rreth 96.56% të aseteve neto. Asetet e këtij fondi zenë një peshë të parëndësishme ndaj totalit të aseteve neto të tregut.

Gjatë 3 mujorit të parë 2018 fondi në Euro ka pësuar një rënie në krahasim me fundvitin 2017. Rënia e fondit në euro e shprehur në lekë për 3 mujorin e parë 2018 krahasuar me vitin 2017 ishte 1.19 miliardë lekë. Paraqitja grafike është si në vijim.

Grafik 11: Vlera Neto e Aseteve të fondeve të investimit



Sa i përket fondeve të pensioneve vullnetare, ato e kryejnë tërësisht aktivitetin e tyre në lekë

III. Përfundime

Pesha e vlerës së asetëve që administrohen prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti është relativisht e ulët. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e mësipërme, niveli aktual i përdorimit të valutës (Euro-s) në tregjet e mbikëqyrura nga AMF është në nivele përgjithësisht të ulëta dhe i diktuar nga profili i veprimtarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Si rezultat, në segmente të caktuara të këtyre tregjeve, nevojat për masa që ulin euroizimin dhe forcojnë përdorimin e monedhës kombëtare, mund të jenë të pranishme. Autoriteti do të monitojë zhvillimet në këto tregje dhe më konkretisht do të fokusohet në drejtim të :

- a) **Ndërgjegjësimit të emetuesve private të titujve për** rreziqet që shoqërojnë huamarrjen në valutë në një kohë që të ardhurat kryesore të veprimtarisë janë në monedhën lek.
- b) **Rritjen e transparencës për produktet që iu ofrohen investitorëve, veçanërisht në drejtim të evidentimit dhe kuptimit sa më të qartë të rrezikut (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të kursit të këmbimit.** Autoriteti gjykon që fenomeni i euroizimit në sistemin financiar reflekton shkallën e përdorimit të valutave në veprimet e agjentëve ekonomikë, dhe vlerëson nevojën për adresimin e kesaj kesaj çështje, në drejtim të rritjes së transparencës ndaj investitorëve.